

**NJOHJA ME POLITIKËN E PRIVATËSISË
DHE
DHËNIA E PËLQIMIT PËR PËRPUNIMIN E TË DHËNAVE PERSONALE**

Për të vijuar me marrjen e këtij shërbimi, ju kërkohet të plotësoni formularin e aplikimit online me të dhënat tuaja personale, si emër, mbiemër, numër telefoni, adresë email-i, si dhe çdo informacion tjetër të kërkuar në rubrikat përkatëse të kësaj faqeje.

Mbrojtja e të Dhënave Personale

INTERSIG Vienna Insurance Group sh.a e konsideron mbrojtjen e privatësisë dhe të të dhënave tuaja personale një çështje me rëndësi të veçantë dhe angazhohet t'i përpunojë dhe mbrojë ato në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi konkretisht Ligjin nr. 124/2024 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale".

Për informacion të detajuar mbi kategoritë e të dhënave që përpunohen, qëllimet e përpunimit, kriteret e përpunimit dhe masat për mbrojtjen e të dhënave tuaja personale, ju lutemi referojuni Politikës së Privatësisë në faqen zyrtare të INTERSIG Vienna Insurance Group sh.a, në seksionin "Politikat e Privatësisë".

Dhënia e Pëlqimit

Duke plotësuar dhe dërguar formularin, ju konfirmoni se të dhënat dhe informacioni që keni dhënë janë të sakta, të plotë dhe të vërteta.

Gjithashtu, duke vijuar me aplikimin, ju jepni pëlqimin për përpunimin e të dhënave tuaja personale nga INTERSIG Vienna Insurance Group sh.a, vetëm për qëllimin e ofrimit dhe administrimit të shërbimit për të cilin me vullnetin tuaj të lirë dhe të plotë, keni vendosur t'i ndani.

Ju keni të drejtë, në çdo moment dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi, t'i drejtoheni INTERSIG Vienna Insurance Group sh.a për të kërkuar akses në të dhënat tuaja personale, si dhe korrigjimin, kufizimin e përpunimit, fshirjen apo ushtrimin e të drejtave të tjera që ju garantohen nga legjislacioni për mbrojtjen e të dhënave personale.

Nëse vendosni të tërhiqeni nga aplikimi përpara se të klikoni butonin "Dërgo", të dhënat që keni plotësuar në formular nuk do të ruhen nga INTERSIG Vienna Insurance Group sh.a, përveç rasteve kur ruajtja e tyre kërkohet ose lejohet nga legjislacioni në fuqi.

Për çdo pyetje ose ankesë lidhur me përpunimin dhe mbrojtjen e të dhënave tuaja personale, mund t'i drejtoheni INTERSIG Vienna Insurance Group sh.a ose Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale.